



**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
PRONËSISË INDUSTRIALE**

KOLEGJI UNIVERSITAR "LOGOS"

Nr. 2636 Prot.

Nr. 184 Prot.

Tiranë, më 05/07 /2024

Tiranë, më 05/07 /2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET:

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE
(DPPI)**

DHE

KOLEGJIT UNIVERSITAR "LOGOS"

KY MEMORANDUM BASHKËPUNIMI LIDHET NDËRMJET:

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE

e njohur më poshtë si “**DPPI**”, i cili është institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin, administrimin dhe promovimin e të drejtave të Pronësisë Industriale në Republikën e Shqipërisë, midis të cilave dhe të drejtat e shpikësve mbi: Shpikjet dhe Modelet e Përdorimit; Disenjot Industriale, Topografitë e Produkteve Gjysmëpërçues; institucioni që krijon, ruan dhe administron bazën e të dhënave për këto objekte të pronësisë industriale, si dhe institucioni përgjegjës për zhvillimin e politikave për promovimin e këtyre të drejtave. DPPI është një insitucion nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për ekonominë dhe ka selinë e vet në Tiranë. Veprimtaria e DPPI përcaktohet dhe rregullohet me anë të Ligjit Nr. 9947, datë 07.07.2008, “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatimin të tij. Misioni i saj është të forcojë mbrojtjen e pronësisë industriale (PI) brenda territorit shqiptar nëpërmjet njohjes, regjistrimit, dhe promovimit të këtyre të drejtave, për të garantuar një nivel mbrojtjeje të njëjtë me atë të vendeve të Bashkimit Evropian.

Adresa e institucionit është: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Shtëpia e Ushtarakëve, Prona Nr. 33, Tiranë, i përfaqësuar nga Titullari:

Znj. Maria Solis – Drejtor i Përgjithshëm i Komanduar;


DHE

KOLEGJIT UNIVERSITAR “LOGOS”

është institucion i Arsimit të Lartë, privat jo fitim prurës, i akredituar dhe përmes strukturës së tij organizative ofron programe studimi të akredituara në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve.

Kolegji Universitar “LOGOS” është institucion i Arsimit të Lartë që ka në fokus formimin akademik, universitar, profesional dhe kërkimin shkencor në fushën e Ekonomisë, Shkencave Humane, Komunikimit Gjuhësor, Informatikës dhe Shkencave Mjekësore.

Adresa e Kolegjit Universitar “LOGOS” është: “Rruga “Dritan Hoxha”, Tiranë/Shqipëri



Në këtë marrëveshje, "Kolegji Universitar LOGOS" përfaqësohet nga **Prof. Dr. Ilia Ninka** në cilësinë e Rektorit të Universitetit.

Duke patur parasysh se:

*Për qëllime të kësaj marrëveshje, **Pronësi Industriale**, pjesë e fushës së Pronësisë Intelektuale, lidhet me krijimet/shpikjet, referuar përcaktimeve ligjore të ligjit Nr.9947, datë 7.7.2008 "Për Pronësinë Industriale" (të ndryshuar) ;*

Subjektet e lartpërmendura, këtej e në vijim do të referohen si "Palët" ose "Institucionet", bien dakord të nënshkruajnë këtë Memorandum Bashkëpunimi, sipas modaliteteve në vijim:

Neni 1

Rëndësia e Bashkëpunimit

1. Palët bien dakort se Pronësia Industriale është një shtyllë e rëndësishme për ngritjen dhe zhvillimin e një veprimtarie të qëndrueshme ekonomike;
2. Ekziston një nevojë imediate për mbështetjen ligjore dhe institucionale të pronësisë industriale, me qëllim mbrojtjen e subjekteve të kësaj pronësie;
3. Palët janë të interesuara të promovojnë dhe të përmbushin objektivat e përgjithshme për mbrojtjen e pronësisë industriale, si dhe të drejtave të Institucioneve të Arsimit të Lartë që angazhohen në veprimtari krijuese dhe shpikëse;
4. Palët shprehin dakordësinë mbi rëndësinë e ndërgjegjësimit të studentëve dhe stafit akademik të universitetit mbi pronësinë industriale, si dhe kontributin e rëndësishëm të tij, në zhvillimin edukativ arsimor të Shqipërisë.

Neni 2

Qëllimi i Bashkëpunimit

1. Promovimi i pronësisë industriale nëpërmjet shkëmbimit të informacionit midis dy institucioneve në këtë marrëveshje;
2. Informimi dhe sensibilizimi i studentëve, stafit akademik shkencor, shpikësve dhe profesionistëve të përfshirë në punë kërkimore shkencore, lidhur me rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale.
3. Informimi mbi të drejtat ekskluzive morale dhe ekonomike që rrjedhin nga prona industriale si një e drejtë që i takon shpikësit/krijuesit të saj dhe pasojat e shfrytëzimit të kësaj të drejte nga palë të treta.
4. Krijimin e infrastrukturës së nevojshme për vënien në dispozicion të studentëve, stafit akademik dhe shpikësve të universitetit, informacione periodike mbi arritjet e mëparshme dhe ato aktuale në fusha të ndryshme të pronësisë industriale si dhe materiale të tjera të nevojshme të

dispozitave ligjore mbi të drejtat dhe detyrimet që shpikësit gëzojnë për pronën e tyre industriale;

Neni 3 **Objektivat e Marrëveshjes**

Objektivi kryesor i Marrëveshjes është të lehtësojë njohjen e konceptit të pronësisë industriale nëpërmjet:

1. Identifikimit të mekanizmave të shpërndarjes së informacionit në lidhje me pronësinë industriale, ku në bashkëpunim me studentët/stafin akademik, të universitetit, të përçohet informacioni i duhur për subjektet/bizneset dhe/ose përdorues të ndryshëm të pronësisë industriale;
2. Vënies në dispozicion e guidave/manualeve/botimeve në Shqip/Anglisht lidhur me regjistrimet kombëtare/ndërkombëtare të krijimeve/shpikjeve të pronësisë industriale, apo/dhe informacione të tjera të ngjashme, në librarinë e universitetit;
3. Organizimit të konferencave të përbashkëta, trajnimeve brenda dhe jashtë vendit, internshipeve, leksioneve të hapura, seminareve, sesione bisedimesh (workshops), praktikave mësimore apo takimeve, pranë ambienteve të DPPI ose Kolegjit Universitar “LOGOS” për dhënien e njohurive praktike nga specialistët e DPPI, mbi pronësinë industriale;
4. Shkëmbimit të ndërsjellë të informacionit në lidhje me funksionin dhe kontributin e Kolegjit në zhvillimin, zgjerimin dhe sensibilizimin e studentëve dhe stafit mbi rëndësinë e pronësisë intelektuale.

Neni 4 **Modalitetet e Bashkëpunimit**

1. Secila palë do të caktojë një koordinator të Marrëveshjes, përgjegjës për zbatimin e saj; Konkretisht nga ana e **Kolegjit Universitar “LOGOS”**, do të jetë Përgjegjësja e Burimeve Njerëzore znj. Edlira Mihali për lehtësi kontaktimi në adresën elektronike: edliramihali@kulogos.edu.al dhe nga DPPI do të jetë znj. Sonila Meka Përgjegjës i **Sektorit të Koordinimit, Analizës dhe Raportimeve**.
2. Mund të ngrihet një grup i përbashkët pune për konkretizimin veprimtarive të ndryshme, në varësi të rastit të bashkëpunimit.
3. Do të vihet në dispozicion për studentët dhe stafin e universitetit, informacioni dhe rezultatet e çdo bashkëpunimi, përmes medias së shkruar dhe asaj vizive.
4. Në veçanti, nëpërmjet koordinimeve të dyanshme, studentët e fushës së ligjit dhe/ose teknologjisë në universitet, do të mund të kryejnë vizita dhe/ose praktika (internships) pranë ambienteve të DPPI-së.



5. Në rast kryerjesh praktikash (internships) të studentëve të universitetit pranë DPPI, kjo e fundit do të lëshojë një vërtetim praktike për studentin përkatës. Gjatë internship-it, universiteti, mund të informohet mbi ecurinë e studentit dhe praktikës së tij nëpërmjet komunikimeve verbale/shkrimore.

Neni 5

Afati i Marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje nënshkruhet për një afat të pacaktuar.
2. Përmbajtja e saj mund të ndryshohet nëpërmjet komunikimeve me shkrim mes palëve.
3. Në rast shfuqizimi të kësaj marrëveshjeje, palët duhet të njoftojnë njëra tjetrën paraprakisht me shkrim të paktën 60 ditë përpara zgjidhjes së saj, mundësisht duke parashtruar dhe arsyet përkatëse.

Neni 6

Dispozita Finale

1. Marrëveshja hartohet dhe pranohet nga palët, duke nënkuptuar se asnjë pjesë e saj nuk është në tejkalim ose kundërshtim të dispozitave përkatëse ligjore, mbi të cilat palët mbështesin ushtrimin e funksioneve dhe kompetencat e tyre.
2. Palët zotohen të zbatojnë vullnetarisht dhe në kushte mirëbesimi këtë marrëveshje. Çdo mosmarrëveshje do të zgjidhet me mirëkuptim.
3. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi nënshkruhet sot më datë 05/07/2024, në 2 (dy) kopje origjinale me vlerë të njëjtë, një për secilën palë dhe hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga të dyja palët.

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
PRONËSISË INDUSTRIALE**

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM I
KOMANDUAR**

Znj. Maria Solis



KOLEGJI UNIVERSITAR "LOGOS"

REKTORI

Prof. Dr. Ilda Ninka

